



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 324/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Hasan Shala, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit dhe dëmtimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar.

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3200 (tremijedyqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Subjekti politik Aleanca Kosova e Re, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik AAK, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, sepse subjekti politik AAK, i ka mbuluar posterat e subjektit politik AKR, duke i vendosur posterat e kandidatëve të saj për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 05.12.2010, nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re, në të cilën theksohet se me datën 02.12.2010 subjekti politik AAK i ka mbuluar posterat e subjektit politik AKR, duke e vendosur posterin e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nga rradhët e AAK z.Shkëlzen Jusaj mbi ate të kandidatit të AKR z.Avdi Mehmetaj, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi nga Sheshi Nëna Terezë dhe rruga Luan Haradinaj në Prishtinë si dëshmi, në të cilën shihet qartë posterin e kandidatit Shkëlzen Jusaj nga rradhët e subjektit politik AAK, që është i vendosur mbi posterat e z.Avdi Mehmetaj kandidat për deputet nga rradhët e subjektit politik të AKR-së.

Parashtresi i ankeses propozon qe të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

PZAP-i e informoi subjektin politik AAK, më datë 05.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik AAK, sipas afatit të caktuar.

### **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërës si në vijim:*

*a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;*

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posteri i kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës Shkëlzen Jusaj, nga radhët e subjektit politik AAK, është vendosur mbi posterin e kandidatit Avdi Mehmetaj nga radhët e subjektit politik

AKR, nga kjo arsye e më qëllim të evitimit të shkeljes së lartë cekur dhe në pajtim me dispozitat e lart cekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 324/2010 më datën 06.12.2010

